

## HAMIT KABA

### 1943-1944: SHQIPTARËT DHE PROJEKTI BRITANIK PËR ZBARKIM NË SHQIPËRI\*

Shqyrtimi me kujdes i dokumenteve arkivore britanike, të hulumtuara vite më parë, në lidhje me idenë dhe planet e Shtabit Aleat [në fakt britanik] për të zbarkuar në Ballkan, më nxiti që këtë çështje ta bëj objekt diskutimi të tryezës sonë. Dokumentet e hulumtuara dëshmojnë se britanikët kishin përpunuar plane të detajuara për administrimin e territoreve të Shtetit të Bashkuar Shqiptar [Shqipëri dhe Kosovë] në periudhën prill-nëntor 1943.

Plani i aleatëve anglo-amerikanë për të zbarkuar në jugun e Italisë [operacioni ‘Husky’] dhe gradualisht për ta larguar këtë të fundit nga radhët e Fuqive të Boshtit, u shoqërua me rritjen e interesit për territoret lindore të Adriatikut, dhe forcimin e rezistencës antifashiste në Jugosllavi, Greqi e në Shqipëri. Për shkak të interesit të njohur për këtë rajon, Britania e Madhe në raport me SHBA kishte rolin e primarit. Të dyja shtetet e mëdha aleate me diferenca disamujore dërguan në Shqipëri misionet e veta. Britanikët u përfaqësuan nga BLO-të [British Liaison Officers-oficerët britanikë të ndërlidhjes], ndërsa amerikanët nga misionet e OSS [Office of Strategic Services - Zyra e Shërbimeve Strategjike], të cilët dhanë kontributin e tyre për çlirimin e vendit nga Fuqitë e Boshtit. Por, siç dëshmojnë, dokumentet e gjetura së fundi në Arkivat Kombëtare Britanikë, komanda ushtarake britanike në periudhën prill-nëntor 1943, kishte hartuar plane për të zbarkuar në Shqipëri e në Ballkan.<sup>1</sup>

Duhet përmendur se deri tani, pothuajse askush nuk është marrë me projektin e zbarkimit britanik në Shqipëri gjatë vitit 1943 dhe me ndikimin e tij mbi luftën për pushtet, ndërmjet Lëvizjes Nacional-çlirimtare [LNÇ] dhe organizatës së Ballit Kombëtar dhe dyshimeve e

\* Kumtesë e mbajtur në tryezën shkencore me temë: “Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore”, organizuar nga Instituti i Historisë, më 5-7 nëntor 2019.

<sup>1</sup> Hamit Kaba, Sabit Syla, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Arkivat Kombëtare Britanikë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, Prishtinë: 2018, f. 174-175; 182, 189-213, 202, 208, 209, 212.

madje mosmarrëveshjeve të krijuara ndërmjet United Nations Relief and Rehabilitation Administration [UNRRA] dhe Military Liaison [ML]. Këtë temë, në këtë këndvështrim, nuk e kanë trajtuar as autorët britanikë, të cilët kanë shkruar gjerësisht për veprimtarinë e BLO-ve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore [LDB]. Enver Hoxha i është referuar jo rrallë, rrezikut që do të sillte zbarkimi aleat për ardhjen në pushtet të forcave të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke filluar nga vjeshta e vitit 1943 dhe veçanërisht në vjeshtën e vitit 1944, kohë, kur britanikët kryen disa operacione kundër gjermanëve me forcat komando, të dërguara enkas në Shqipëri.<sup>2</sup>

Planet britanike për zbarkim në Ballkan dhe jo në Evropën Qendrore sikurse mendonin amerikanët, janë bërë objekt diskutimesh e kundërshtish ndërmjet politikanëve të lartë të asaj kohe, veçanërisht ndërmjet Presidentit Roosevelt dhe Kryeministrit Churchill. Në këtë debat kanë marrë pjesë edhe historianë të dy vendeve. Studiues të njohur amerikanë, si Hanson Baldwin (*Great Mistakes of the War-1950*), Trumbull Higgins (*Soft Underbelly-1968*) etj., kanë pranuar se britanikët donin të zbarkonin në Ballkan. Sipas tyre, Winston Churchill kishte planifikuar që trupat ushtarake britanike të zbarkonin në vitin 1943 në Ballkan, dhe si rrjedhojë do të ruhej ndikimi i qeverisë britanike në këtë rajon, ku ajo kishte interesa të veçantë.

Por, as Kryeministri Churchill dhe as historianët e njohur britanikë si John Ehrman, Michael Howard etj., nuk e kanë pranuar se ka ekzistuar një plan alternativ me atë të zbarkimit në Evropën Qendrore. Ata e kanë cilësuar atë si ‘legjendë e pasluftës’.<sup>3</sup> “Në Amerikë, ka shkruar Winston Churchill, kanë qarkulluar legjenda sikur unë kam bërë jo pak përpjekje dhe orvatje për të shtyrë operacionin për kalimin e La Manshit (*Overlord*), dhe për të tërhequr aleatët në zbarkimin masiv në Ballkan, në fushatën masëgjërë në Mesdheun Lindor, gjë që do të lejonte të hiqej dorë përfundimisht nga “*Overlord-i*”.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Enver Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë, Kujtime*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982.

<sup>3</sup> F.W.D. Deakin, “The Myth of an Allied Landing in the Balkans during Second World War (with particular reference to Yugoslavia)”, në *British Policy towards Wartime resistance in Yugoslavia and Greece*, edited by Phyllis Auty and Richard Clogg, London: The Macmillan Press Ltd, 1975, f. 94.

<sup>4</sup> Winston Churchill, *Lufta e Dytë Botërore, Kujtime*, vëll. IV, Tiranë: Fan Noli, 2006, f. 94.

Projekti britanik për zotërimin e Ballkanit dhe vënia para faktit të kryer e Ruisë Sovjetike, nuk u realizua, sepse ai u kundërshtua nga D. Roosevelt-i, duke filluar me Konferencën e tretë të Washington-it [12-25 maj 1943], dhe duke vazhduar më tej me Konferencën e Moskës [9-18 tetor 1944] dhe të Teheranit [28 nëntor -1 dhjetor 1943]. Në raportin final të Konferencës së Washington-it, më 18 maj 1943, Shefat e Shtabit të Përbashkët rekomanduan që operacionet e Aleatëve në Ballkan, duhej të ishin të kufizuara dhe të përqendroheshin kryesisht në ofensiva ajrore.

Churchill-i nuk hoqi dorë nga përpjekjet për t'u marrë vesh me Stalinin dhe për të ndarë zonat e influencës në Ballkan. Në maj 1944 ai i propozoi mareshalit Stalin planin e vet, që Greqia të mbetej nën kontrollin e Britanisë së Madhe, ndërsa Rumania t'i kalonte Ruisë. Stalini nuk e kundërshtoi propozimin e Kryeministrit britanik, por kërkoi paraprkishtë që ai të kishte edhe pëlqimin e Presidentit Roosevelt. Ky i fundit e refuzoi me këmbëngulje dhe e quajti atë, si përpjekje për ndarjen e zonave të interesit. Kryeministri britanik nuk hoqi dorë nga plani i vet, dhe nga përpjekjet për të ruajtur kontrollin së paku në disa vende të Ballkanit, veçanërisht në Greqi, por edhe në Jugosllavi. Përpjekjet e mëdha të Churchill-it dhe delegacionit britanik për të ruajtur ndikimin britanik në Jugosllavi, pavarësisht nga çfarë u tha e u shkrua në takimin e Moskës [9-18 tetor 1944], rezultuan të pasuksesshme<sup>5</sup>, sepse fati i vendeve ballkanike, përveç Greqisë, u vendos në fushën e betejës nga Ushtria e Kuqe, e cila okupoji shumicën e vendeve të Europës Juglindore e të Ballkanit.

Mosbesimet dhe dyshimet e amerikanëve ndaj britanikëve nuk u shuan pas vendimeve të marra në Konferencën e Moskës e të Teheranit, por vazhduan edhe më mbrapa. Pasojat e tyre u reflektuan në klimën e dyshimit që u vu re në marrëdhëniet e UNRRA-s me ML dhe specialistëve të tyre amerikanë e britanikë për Shqipërinë.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Oleg A. Rzheshesky, "Moscow. 9-18 October, 1944. Percentage Agreement and Polish Deadlock", in *Stalin and Churchill, Meetings, Talks, Discussions, Documents, Commentaries 1941-1945*, Moscow: Nauka, 2004. (O. A. Ржешевский, *Сталин и Черчилль. Встречи. Беседы. Дискуссии. Документы, комментарии, 1941-1945*, Москва: Наука, 2004, f. 412-487); Elisabeth Barker, *British Policy in Southeast Europe in the Second World War*, London: 1976, f. 116.

<sup>6</sup> Hamit Kaba, *UNRRA në Shqipëri, 1944-1947*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Shkenca, 2000, f. 191-246.

## **Shqipëria dhe Kosova në projektin britanik të administrimit të Shqipërisë, prill- nëntor 1943**

Zgjedhja e kësaj teme për diskutimin e sotëm, nuk ka si qëllim të mirëfilltë të japë argumente në favor të njëjës apo tjetrës tezë, por të hedhë dritë mbi pasojat e projektit britanik për zbarkimin në Shqipëri dhe ndikimin që ai pati mbi rezistencën në Shqipëri. Dokumentacioni i njohur vetëm sa e përmend planin e zbarkimit, por nuk jep detaje në lidhje me mënyrën e realizimit të tij. Përkundrazi, aty gjendet informacion i bollshëm e i hollësishëm për mënyrën se si do të administroheshin territoret e Shtetit të Bashkuar Shqiptar. Administrimi ushtarak i territoreve shqiptare në periudhën prill-nëntor 1943 nuk ishte thjesht një ide, por një plan i mirëmenduar, madje deri diku i detajuar. Dokumentacioni që njohim nuk na jep të dhëna për planin dhe mënyrën se si do të hynin trupat ushtarake britanike në Shqipëri, por se si do të administroheshin territoret shqiptare nga ushtarakët britanikë gjatë kohës së luftës. Besojmë dhe mendojmë se duhet të ketë pasur edhe plane e projekte ushtarake për okupimin e Shqipërisë, sepse administrimi ushtarak i territoreve shqiptare apo më gjerë në Ballkan, ishte pasojë e zbarkimit të trupave ushtarake britanike. Duket se, dokumentet për zbarkimi britanik në Shqipëri e në Ballkan vazhdojnë të jenë ende të klasifikuara.

Planet strategjike britanike të periudhës prill-maj 1943 parashikonin një aksion të kufizuar në Durrës dhe në ishujt Dodekanez [Greqi], duke llogaritur tërheqjen apo pakësimin e forcave gjermane në Ballkan, në favor të përforcimit të frontit italian. Operacionet e komandës britanike parashikonin gjithashtu pushtimin e Greqisë e të Kretës, dhe më tej, futjen e trupave britanike në Turqi. Dokumentet arkivore britanike për Shqipërinë [shih: The National Archives-TNA] nuk tregojnë aspak për aksione të pjesshme të forcave britanike, por për zotërimin e plotë të Shqipërisë. Dokumentet e shfrytëzuara i përkasin fondit të Ministrisë së Luftës [War Office-WO] dhe Ministrisë së Jashtme [Foreign Office- FO] etj. Pas okupimit, Shqipëria, sikurse edhe Jugosllavia do të qeveriseshin nga njësi të veçanta, të cilat vareshin nga Seksioni i Administrimit të Territoreve për Ballkanin.

Dokumentacioni arkivor britanik, në lidhje me Administratën e Territoreve të Pushtuara na jep informacion të mjaftueshëm, për mënyrën

se si do ta administronin ushtarakët britanikë Shtetin e Bashkuar Shqiptar dhe ‘territoret e lira’ [Kosovën dhe territoret e tjera shqiptare], të bashkuara me të në gushtin e vitin 1941; se si do të klasifikohesh Shqipëria, si një shtet mik apo një shtet armik; se cilat do të ishin raportet e administratës së re me administratën e vjetër, nëse do të ruheshin apo do të largoheshin nëpunësit italianë; se ç’do të bëhej me territoret e Kosovës, do të vazhdonin të qëndronin të bashkuara me shtetin shqiptar, apo do t’i bashkëngjiteshin Jugosllavisë; nëse do të lejohej apo do të refuzohej futja e trupave të qeverisë greke në emigracion në Shqipërinë e Jugut pas dorëzimit të Italisë; se cili flamur do të përdorej në Shqipëri, ai i shqiptarëve apo i britanikëve etj.

Përcaktimi i statusit të Shqipërisë si një vend mik apo armik i Aleatëve u bë objekt diskutimi në rrethet ushtarake dhe në qeverinë britanike. Komiteti i Administrimit të Territoreve, nën ndikimin e ushtarakëve, më 7 prillit 1943 kishte vendosur që ‘Shqipëria të trajtohej si territor armik’. Një trajtimi i tillë do të prekte disa aspekte të rëndësishme të marrëdhënieve të Aleatëve me Shqipërinë, ndërsa ndikonte direkt mbi mënyrën se si do administroheshin territoret shqiptare. Por, Ministria e Jashtme Britanike më 28 qershor 1943 mori vendim, që ta trajtonte Shqipërinë si ‘territor mik’. Trajtimi i Shqipërisë me këtë status bazohej te deklarata e qeverisë britanike e 17 dhjetorit 1942, që njihte pavarësinë e Shqipërisë. Njohja e këtij statusi u shoqërua me disa vendime shoqëruese dhe u dha përgjigje çështjeve të mëposhtme:

1. U ritheksua ideja se problemi i kufijve të Shqipërisë do të zgjidhej në Konferencën e Paqes pas mbarimit të luftës.

2. Administrata do të kishte në përbërjen e saj vetëm shqiptarë, ndërsa shtetasit italianë, grekë apo jugosllavë nuk do të ishin pjesë e saj.

3. Në përgjithësi pranohej ideja e ndarjes së territoreve shqiptare të Kosovës nga shteti shqiptar dhe bashkimi i tyre me Jugosllavinë e okupuar sikurse Shqipëria nga britanikët. Por ky proces nuk do të ishte i menjëhershëm.

4. Njohja e territoreve shqiptare me statusin e një ‘vendi mik’, do të pasohej nga përdorimi i flamurit shqiptar.

Zbarkimi i ushtarakëve britanikë në Shqipëri, siç dëshmojnë dokumentet u shoqërua me projekte të hollësishme për administrimin e territoreve shqiptare, pjesë e të cilave ishte edhe Kosova. Administrimi i territoreve shqiptare ishte planifikuar të bëhej nga Seksioni shqiptar i Komitetit për Administrimin e Territoreve Ballkanike, i cili ishte pjesë e

Administratës Civile të Institucionit të Luftës [Civil Administration of War Establishment]. Një seksion i veçantë i kësaj të fundit do të krijohet edhe për Jugosllavinë.

Dokumentacioni arkivor dëshmon qartazi, se zgjidhja përfundimtare e problemit të territoreve shqiptare dhe kufijve të Shqipërisë do të bëhet në Konferencën e ardhshme të Paqes. Çështja e kufijve zuri vend në disa memorandume të njëpasnjëshme, të përgatitura nga ushtaraku britanik Phillips Brocklehurst. Ai gjykonte se Qeveria e Madhërisë së Tij nuk duhet të angazhohej në asnjë mënyrë përpara kohe për çështjen e kufijve.<sup>7</sup> Në direktivën e 5 shtatorit Brocklehurst udhëzonte oficerin vartës që, ‘në parim kufijtë e 1939-s, duhej të miratoheshin për qëllime administrative, por, sipas rrethanave, për arsye menaxhimi mund të ruhej edhe gjendja ekzistuese, pra kufijtë e vitit 1941. “Qëllimi juaj duhet të jetë krijimi i një sistemi të paanshëm administrativ, i cili mund të funksionojë me sukses deri në kohën që vendi të jetë në gjendje të vendosë për formën e regjimit dhe qeverinë që është përgatitur të pranojë në të ardhmen”.<sup>8</sup> Pika 7 dhe 8 e udhëzimit merrej me administrimin e ‘territoreve të lira’, i cili konsiderohej si një problem delikat, për shkak të ndjeshmërisë së lartë dhe frymës së papajtueshmërisë së shqiptarëve dhe serbëve. “Këto territore, shkruante ai, janë përfshirë në Shqipërinë e Madhe nga aksioni i kombinuar agresiv i Italisë dhe Shqipërisë, dhe deri kur çështja e kufijve të zgjidhet në Konferencën e Paqes, do të jetë logjike që ato të konsiderohen si pjesë e Jugosllavisë. Megjithatë duhet mbajtur parasysh që ndjenjat shqiptare dhe ato jugosllave janë shumë të larta në lidhje me përkatësinë e këtyre territoreve, dhe për rrjedhojë, duhet të jetë vendosmëria juaj e cila do të shmangë çdo veprim që do të prekte ndjeshmërinë e secilës palë, pasi kjo do të çonte në një situatë serioze ndërkombëtare”.<sup>9</sup> Në pikën 8 bëhet e qartë se për qëllime planifikimi, parimisht ‘territoret e lira’ do të përfshiheshin nën kontrollin e Komitetit Britanik të Luftës për Jugosllavisë, por ato do të administroheshin përkohësisht nga administrata britanike për Shqipërinë, deri në kohën që të krijohet institucioni i duhur edhe për Jugosllavinë. Kontrolli nga Tirana do të pranohej pashmangshmërisht nga të dyja palët [shqiptarët

<sup>7</sup> *The National Archives*, London (më tej: TNA), *War Office* (WO), 204/9522- HS-AFHQ 112/15. Draft Memo (direktivë për DCCAO-Shqipëri) e Philips Brocklehurst, 5 shtator 1943, f. 16.

<sup>8</sup> *Po aty*, f. 17.

<sup>9</sup> H. Kaba, S. Sylja, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore...*, f. 192-193.

dhe serbët]. Brocklehurst porosiste që, kur të krijohet seksioni jugosllav, komanda duhej të kalonte nga administratorët britanikë të Shqipërisë tek administratorët britanikë të Jugosllavisë.

Më 18 tetor 1943, Phillips Brocklehurst përgatiti një memorandum tjetër për administrimin e Shqipërisë nga britanikët.<sup>10</sup> Pika 3 e memorandumit trajtonte problemin e Kosovës dhe të kufijve të Shqipërisë, për të cilët thuhej se do të zgjidheshin në Konferencën e Paqes. Por, “kjo deklaratë me vend dhe e admirueshme, theksonte ai, mund të pengohet nga ndonjë aksion i pavarur dhe i shpejtë i grekëve dhe jugosllavëve”. Ekzistonte rreziku që trupat e këtyre dy vendeve mund të futeshin në territoret shqiptare, përpara mbarimit të luftës, dhe si rezultat, të shkakttoheshin konflikte me shqiptarët. Ushtaraku britanik e konsideronte Shqipërinë dhe Italinë dy vende agresore që kishin aneksuar territore jugosllave, fakt, që sipas tij nuk justifikoheshin as prania mbizotëruese e shqiptarëve. “Aktualisht, shkruan ai, këto zona administrohen nga Shqipëria, por me sa duket, pas tërheqjes së trupave gjermane, këto zona logjikisht duhet t’i kthehen Jugosllavisë në pritje të vendimit të Konferencës së Paqes”.<sup>11</sup> Kalimi i territoreve shqiptare Jugosllavisë shihej si një akt i përkohshëm, pasi vendimin përfundimtar për kufijtë do ta merrte Konferenca e Paqes, ndërsa Qeveria e Madhërisë së Tij nuk duhej të angazhohej në asnjë mënyrë para kohe. Autori shpresonte që, si shqiptarët ashtu edhe serbët të pajtoheshin me këtë koncept, por dyshimi ishte i madh. “Ka të ngjarë, përmendte ai, që Shqipëria dhe Jugosllavia nuk do të pajtohej më të drejtat e zotërimit [të Kosovës]. Kështu sa do e lehtë që mund të jetë për organizatën e çështjeve civile që të mbajë qëndrim të paanshëm, është shumë që të pritët që këta popuj ballkanikë të bëjnë të njëjtën gjë”. “Nëse aneksimet italo-shqiptare në Jugosllavi u kthehen logjikisht jugosllavëve, apo merren para kohe prej tyre, mund dhe duhet të bëhen disa modifikime në favor të tyre”.<sup>12</sup>

Moszbatimi i projektit britanik për zbarkimin në Shqipëri e Ballkan e përjashtoi mundësinë e bashkëngjitjes së territoreve shqiptare me Jugosllavinë ende pa mbaruar lufta. Administrata e Kombeve të Bashkuara

---

<sup>10</sup> TNA, WO 204/9522-HS-AFHQ 112/15. Phillips Brocklehurst: “Memorandum mbi pikat në lidhje me trajtimin e Shqipërisë, për të cilat duhet kërkuar vendimi i Ministrisë së Jashtme [FO]”, tepër sekret, 18 tetor 1943, f. 58-62.

<sup>11</sup> *Po aty.*

<sup>12</sup> *Po aty.*

për Ndhimë dhe Rimëkëmbje [UNRRA-United Nations Administration for Relief and Rehabilitation] dhe Ndërlidhja Ushtarake [ML-Military Liaison] në prill 1944 hartuan të parin plan për t'i dhënë ndihma civile Shqipërisë.<sup>13</sup> Të tërheq vëmendjen fakti që plani i mësipërm përcaktonte një kontingjent të veçantë ndihmesh për Kosovën, që do të arrinte në 1.442 ton në muaj. Për ta përmbushur atë ML do të ngarkonte edhe 18 ushtarakë të tjerë, ndërsa UNRRA nga ana e vet edhe 58 persona.<sup>14</sup> Ndërlidhja ushtarake për Shqipërinë do të ishte përgjegjëse edhe për operacionin e dhënies së ndihmave për Kosovën. Përfshirja e furnizimeve të Kosovës në planin e hartuar për shtetin shqiptar, me sa duket, u konsiderua jo e drejtë nga organet eprorë. Në planet e tjera të hartuara gjatë vitit 1944 nuk përmenden më ndihmat për Kosovën në kuadrin e shtetit shqiptar.<sup>15</sup> Duket se aleatët anglo-amerikanë e shihnin të ardhmen e këtij territori jashtë shtetit shqiptar.

### **Zbarkimi i britanikëve dhe pasojat e tij në Shqipëri**

Në vjeshtën e vitit 1943, zbarkimi aleat dukej sikur ishte një çështje e ditës. Pothuajse të gjithë në Shqipëri e prisnin zbarkimin aleat, duke filluar nga gjermanët, qeveria kuislinge, Lëvizja Nacionalçlirimtare, Balli Kombëtar e Legaliteti. Zbarkimi i Aleatëve do të kushtëzonte të ardhmen e vendit, si dhe statusin e pozitën e ardhshme të forcave politike e ushtarake në Shqipëri. “Dy javë pas kapitullimit të Italisë, ka shkruar oficeri britanik i SOE-s, Peter Kemp, pothuaj të gjithë në Shqipëri, qoftë gjermanët ose italianët, britanikët dhe shqiptarët, LNÇ dhe ‘Balli Kombëtar’, të gjithë besonin një gjë: pritej së shpejti një zbarkim i Aleatëve në Ballkan”.<sup>16</sup> “Pas rënies së Italisë, përmendet në një dokument britanik për raportet e forcave të rezistencës në Shqipëri, rezistenca shqiptare u ndikua negativisht nga përkeqësimi i shpejtë i situatës politike. Me fundin e sundimit italian dhe prirjen e favorshme të luftës, u frymëzua një optimizëm tejet i pajustificueshëm në radhët e shqiptarëve, të cilët shpresonin në çlirimin e tyre të shpejtë nëpërmjet zbarkimit të Aleatëve.

<sup>13</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: AMPB), Fondi (më tej: F.) i UNRRA-s, Viti (më tej: V.) 1944, Dosja (më tej: D.) 61, fl. 2-3.

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> Hamit Kaba, *Nga lufta në paqe. Shqipëria dhe ShBA 1939-1946*, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 351-352; AMPB, V. 1946, D. 61, fl. 3.

<sup>16</sup> William Tilman, Julian Amery, Peter Kemp, *Kujtime që nuk shlyhen, Tre oficerë anglezë gjatë luftës në Shqipëri dhe në Kosovë*, përktheu Xhevat Loshi, Tiranë: Toena, 1997, f. 209.



Si rezultat, çështjet e brendshme politike morën një rëndësi të madhe dhe në mënyrë proporcionale u zvogëlua vullneti për t'i rezistuar armikut. Gjermanët e shfrytëzuan me zgjuarsi kërcënimin komunist që vinte nga LNÇ dhe arritën të sigurojnë bashkëpunimin me Ballin Kombëtar.<sup>17</sup>

Zbarkimi i Aleatëve u prit me shumë rezerva nga LNÇ dhe Partia Komuniste Shqiptare [PKSH], për dy arsye: *së pari*, sepse 'Komiteti i Shpëtimit' i krijuar në Mukje nga marrëveshja e LNÇ me Ballin Kombëtar, mund të merre atributet e një qeverie në miniaturë pas zbarkimit të Aleatëve, ndërkohë që përbërja e tij dominohej nga nacionalistët; *së dyti*, përfaqësuesit e LNÇ ndiheshin të rrezikuar nga zbarkimi i Aleatëve në Shqipëri, sepse për vetë natyrën 'kapitaliste' e 'imperialiste' të shteteve të tyre dhe të ekzistencës së 'elementëve reaksionarë' brenda qeverive angleze e amerikane, ata do të përpiqeshin të vendosnin 'qeveri reaksionare' në vendet e shtypura. Në qarkoren që Enver Hoxha u drejtonte Komiteteve Qarkore të Partisë më 9 nëntor 1943, shkruante: "zbarkimi i aleatëve në Ballkan ose edhe në Shqipëri, nuk asht ma një perspektivë shumë e largët... në shtresat e nalta të popullit dhe në qeverinë e vet angleze ka elementa reaksionare, të cilët duan me vendos fuqinë reaksionare në vende të shtypuna dhe bash për këtë arsye kanë formue dhe tentojnë të formojnë qeverinë reaksionare në Londër"...Nuk përjashtohet mundësia e formimit të një qeverie të tillë shqiptare në Londër ose të ndihmojnë për të krijuar në vend...".<sup>18</sup> Jo rastësisht në këtë periudhë Enver Hoxha, në emër të Komitetit Qendror të PKSH, ka lëshuar disa qarkore e urdhra në lidhje me zbarkimin e Aleatëve në Shqipëri, të shoqëruara me paralajmërimin për të mos lejuar përzierjen e tyre në problemet e brendshme të vendit dhe me kërkesën për forcimin e këshillave dhe të ushtrisë nacionalçlirimtare.

Megjithëse plani i britanikëve për zbarkim në Greqi, Jugosllavi e Shqipëri u refuzua nga amerikanët, në mënyrë të veçantë në Konferencën e Parë të Quebec-ut (17-24 gusht 1943), dyshimet nuk u shuan as më pas. Elisabeth Barker ka shkruar se, pas kësaj periudhe, britanikët hoqën dorë nga plani i tyre për zbarkim në Ballkan. Operacionet e Aleatëve në këtë rajon do të ishin të kufizuara. Ato do të përqendroheshin në dhënien e furnizimeve për gueriljet ballkanike, nëpërmjet transportit ajror dhe detar, dërgimit të forcave të vogla komando dhe bombardimit të objekteve

<sup>17</sup> TNA, HS 5/66, "Shqipëria, aktiviteti partizan për periudhën 17 shkurt 1943 - 8 janar 1944".

<sup>18</sup> AQSH, F. 14/AP, V. 1943, D. 11, fl. 17. Qarkore e Komitetit Qendror të PKSH (Shpati) drejtuar Komiteteve Qarkore të Partisë, 9 nëntor 1943.

strategjike.<sup>19</sup> Dyshimet për zbarkimin e Aleatëve ushqeheshin veçanërisht nga propaganda gjermane, por edhe nga vetë Aleatët, të cilët donin të maskonin operacionin e tyre të zbarkimit në Normandi. Për zbarkimin e Aleatëve vazhdonte të fliste Enver Hoxha në emër të LNÇ dhe Mit'hat Frashëri në emër të Ballit Kombëtar. Tajar Zavalani nga Londra, përshëndeste pjesëmarrjen e trupave komando britanike në operacionin për çlirimin e Sarandës, dhe mundësinë e atashimit të Shqipërisë me Perëndimin. Por, dyshimet për zbarkimin aleat kishin zënë vend edhe te një pjesë e personelit të misioneve të ML e UNRRA-s për Shqipërinë, madje edhe në nivelet e larta të tyre. Dyshimet dhe rezerva për planet e britanikëve në Ballkan u panë disi edhe në rangjet e larta të politikës amerikane.

Mosmarrëveshje u vunë re në marrëdhëniet e personelit të UNRRA-s me ata të ML, por në disa raste edhe brenda misionit të UNRRA-s. Debatet dhe polemikat nuk kishin të bënin edhe aq me nacionalitetet e anëtarëve të misioneve, nëse ata ishin amerikanë apo britanikë, por me vështrimet e tyre të ndryshme politike, me diferencat ekonomike në pagesa [amerikanët paguheshin më shumë se britanikët] dhe me kulturat e ndryshme të shërbimit etj.<sup>20</sup> Bashkëpunimi i UNRRA-s me ML nuk u ka shpëtuar vërejtjeve, të bëra nga njëri prej kryetarëve të Misionit të UNRRA-s në Shqipëri, britanikut Peter Floud. UNRRA u kritikua sepse bashkëpunoi me një organizatë ushtarake siç ishte ML, duke zbehur karakterin e saj si organizatë civile ndërkombëtare.<sup>21</sup> Ministria e Luftës e SHBA shfaqti dyshime ndaj planeve të Ministrisë Britanike të Luftës, dhe nuk lejoi që personeli ushtarak amerikan në Itali të përfshihej në operacionet e trupave komando britanikëve në Ballkan e në Shqipëri. Gjithashtu, amerikanët e ML dhe të UNRRA-s nuk u lejuan nga komanda e tyre, që të shkonin në Greqi, Jugosllavi e në Shqipëri, ende pa mbaruar lufta. Oficerët dhe civilët amerikanë të këtyre dy organizatave u futën në këto vende vetëm pas mbarimit të luftës dhe tërheqjes së gjermanëve.

Dyshimet më të mëdha për zbarkimin e britanikëve në Shqipëri u vunë re sidomos në muajin shtator-tetor 1944, kur Misioni i ML për

<sup>19</sup> Elisabeth Barker, *British Policy in South-East Europe in Second World War*, London: Macmillan Press LTD, 1976, f. 116.

<sup>20</sup> *UNRRA: The History of The United Nations Relief and Rehabilitation Administration*, prepared by a special staff under direction of George Woodbridge - chief historian of UNRRA, in three volumes, vol. II, New York: Columbia University Press, 1950, f. 86.

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 89.

Shqipërinë u ngarkua nga Komanda e Ndërlidhjes Ushtarake Aleate që të hartonte një plan të detajuar të veprimeve të saj të ardhshme në Shqipëri. Gjatë hartimit të tij duhej që të merreshin në konsideratë kushte të tilla, si: futja në Shqipëri e një kontingjenti të vogël ushtarakësh aleatë; krijimi i lehtësirave të nevojshme për ta nga pala shqiptare, si dhe pranimin e dy principeve bazë që kishin të bënin me shpërndarjen e barabartë të furnizimeve [pa dallime fetare, raciale, krahinore] dhe vëzhgimin e tyre të vazhdueshëm nga personeli i ML dhe i UNRRA-s. ML-së fillimisht iu dha direktivë që të mos kontaktonte direkt me Enver Hoxhën dhe qeverinë e tij, për arsye të mosnjohjes së autoritetit dhe të forcës politike që ai drejtonte. Në direktivën e Komandës së Forcave Aleate të datës 23 shtator 1944 parashikohej që, Balkan Air Force [Forcat Ajrore të Ballkanit] do të angazhonin një brigadë të Forcave Tokësore të Adriatikut, e cila do të zbarkonte në Shqipëri pa miratimin e udhëheqjes së lartë të FNÇ. Në detyrat e saj nuk bënte pjesë vetëm mbarëvajtja dhe garantimi i ndihmave, por edhe detyrime të tjera, që nuk kishin të bënin direkt me vendosjen e rendit në vend, dorëzimin e gjermanëve, moslejimin që armët e tyre të binin në duart e kuislingëve shqiptarë etj. Plani i Aleatëve parashikonte që trupat ushtarake do të vendoseshin në zonën e Durrësit ose të Vlorës, vende ku mendohej se do të depozitoheshin edhe furnizimet e tyre.<sup>22</sup>

Më 14 tetor, Shefat e Shtabit Aleat e anuluan planin e shtatorit dhe morën vendim që të mos e dërgonin brigadën e planifikuar për të zbarkuar në Shqipëri. Dokumentet britanike përmendin si shkak të anulimit të saj, mungesën e trupave ushtarake në dispozicion për operacionin e lartpërmendur, të cilat, thuhej se ishin angazhuar në çlirimin e Greqisë.<sup>23</sup> Por, nuk duhet harruar edhe presioni që u ushtrua mbi britanikët nga Enver Hoxha, i cili kërkoi në mënyrë ultimative, tërheqjen e trupave të tyre nga Shqipëria menjëherë pas përfundimit të operacionit për çlirimin e Sarandës në tetor 1944. FO i tërhoqi gjithashtu vëmendjen Komandës britanike, që të tërhiqte trupat e veta komando nga Saranda, dhe të mos krijonin probleme me përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, në rrethanat kur politika britanike po diskutonte për të lënë në fatin e vet, përfundimisht nacionalistët shqiptarë dhe po përpiquej që ta modifikonte nga brenda LNÇ. Megjithëkëtë, ushtarakët britanikët nuk hoqën dorë menjëherë. Ata e

<sup>22</sup> TNA, CAB 106/459, *Military Liaison, Albania, British Historical Section-Central Mediterranean* [Ndërlidhja Ushtarake-Shqipëria, Seksioni Historik Britanik i Mesdheut Qendror], 31 mars 1946, f. 146.

<sup>23</sup> *Po aty*, f. 147.

modifikuan planin e parë, dhe më 15 tetor vendosën që trupat ushtarake që morën pjesë në operacionin e Sarandës të riorganizoheshin në kuadrin e operacionit *Houndforce* dhe të përparonin drejt veriut për të zënë Vlorën. Por, as porti i Vlorës nuk e kishte kapacitetin e duhur për të përballuar fluksin e ndihmave të Albanian Military Liason (AML). Planet e ushtarakëve ndeshën në refuzimin e politikanëve të lartë aleatë, amerikanë apo britanikë. Këshilltari politik i SHBA dhe ministri rezident britanik në Caserta, u kërkuan Shefave të Shtabit, që të këshilloheshin me ta, përpara se të ndërmerrnin operacionin e ndihmave për Shqipërinë.